



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 506, datë 28.09.2023

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË
NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE,
TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 502 DATË 21.11.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 28.09.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin pasurisë dhe figurës së kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatit, z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale (tashmë gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm).

1.1 Me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale (tashmë gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm).

2. Në këtë procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë/Durrës (tashmë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm) afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

3. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimet si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar i Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

4. Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

5. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 23.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

7. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pranë ILDKPKI-së.

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.03.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së

Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

9. Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022, përfshirë edhe për kandidatin z. {...}. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidatit në fjalë, me short, si relator, është caktuar Kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019), si dhe pikën 9, të Vendimit nr. 502 dhe nr.503 datë 21.11.2022, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatit në lidhje me kriteret formale¹ të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 264, datë 24.05.2023, Këshilli vendosi:

- 1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*
- 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 499 datë 21.11.2022, si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të*

¹ Kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatën e posaçme dhe në gjykatën e shkallës së dytë janë: “përvoja profesionale minimale”, “dhënia e pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022.

10. Kandidati me kërkesën datë 14.06.2023 administruar në Këshill me shkresën nr. 3584 prot., datë 21.06.2023 ka paraqitur dorëheqjen nga kandidimi për pozicionin e lirë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës/Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit.

10.1 Këshilli, me vendimin nr.503, datë 28.09.2023 ka vendosur: *“Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimin nr. 503 datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.*

2. *Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.*

11. Pas vendimmarrjeve të më sipërme të Këshillit, kandidati është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së këtij kandidati në kuadër të ngritjes në detyrë.

12. Në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

13. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

14. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës për kandidatin {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 07.09.2023, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

15. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 07.09.2023 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, ose skualifikimin e kandidatit dhe përjashtimin e tij nga procedurat e ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

16. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: “7. *Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.* 8. *Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

17. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019). Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidojnë për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

18. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar”, përcaktohet se: “1. *Kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e*

Shqipërisë”. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i Këshillit mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit. 2. Për kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta kandidatë fillon verifikimi i pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procedura e verifikimit përmbyllet mbas dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar. 3. Marrja e masës disiplinore sipas neneve 60 dhe 61, të Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar”.

18.1 Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidati që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të verifikimit të figurës, ky kandidat i nënshtrohet verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

19. Rezulton se kandidati, z. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Ai është konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 393, datë 03.06.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Pas shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit me Vendimin nr. 27, datë 06.07.2022 ka vendosur: “Lëniën në fuqi të vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm”. Verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën 26.01.2017 deri më 15.03.2023.

A. Për kriterin e pasurisë

20. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32², të Ligjit për Statusin, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

² “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që

21. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 66/24 prot., datë 19.05.2023.

21.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

21.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

22. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

22.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 4011/2 prot., datë 24.03.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1776/11 prot., datë 29.03.2023 ku për kandidatin {...}, nuk rezultuan të jenë të regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...".

22.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 4560/1 prot., datë 11.04.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1776/14 prot., datë 12.04.2023, ku për kandidatin {...}, nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

23. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidatin, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

24. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërorë dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

25. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar, depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B. Për kriterin e figurës

26. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

27. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

28. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 263/1 prot., datë 24.03.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr.1776/10 prot., datë 27.03.2023, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidatin z. {...}.

29. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, në kushtet kur ky kandidat ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

30. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 1732/4 prot., datë 13.03.2023, ku për kandidatin {...} është bërë me dije se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 25.04.2016; -formulari është regjistruar me numrin unik 000185- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile; - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

31. Kandidati z. {...} i’u nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes 1976), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019.

31.1 Me kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 526/3 prot., datë 24.03.2023 dhe me Shkresën nr. 590/7 prot., datë 23.03.2023, Vendimin nr. 185 datë 23.03.2023, me të cilin është vendosur: *“Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 1776 prot., datë 09.03.2023, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, se nga verifikimet e kryera deri tani për z. {...} nuk rezulton: a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; të ketë qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit; anëtar i ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

32. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të

skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar, depozituar rregullisht formularin të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e kandidatit, mbi të cilat mund të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të emërimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Klodian Kurushi,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022.
2. Vendimi nr. 264, datë 24.05.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR